



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës

Adresa: Bulevardi: “Zhan D’Ark” Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax:+355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr.Dok. 202001603/8

Tiranë 29 / 12 /2020

Lënda: *Rekomandim lidhur me vazhdimin e përfitimit të bonusit të qirasë të shtetasit z.B.H.*

Drejtuar : **BASHKISË**
Z.Kryetar

SARANDË

I nderuar Z.Kryetar,

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, siç jeni në dijëni, ka paraqitur një ankesë shtetasi z.B.H banues në Sarandë, i cili ankohet lidhur me mos kompesimin e bonusit të qirasë për vitin 2019 e në vazhdim. Konkretisht “.....Z.B.H ankohet se deri në vitin 2018 i është kompesuar pagesa e qirasë së banesës nga ana e Bashkisë Sarandë në vlerën 5000 lekë/muaj. Ndërkohë për vitin 2019 e në vazhdim nuk i është kompesuar dhe kjo po i rrezikon të mbetet pa banesë në pamundësi të pagesës mujore.....”

Pas regjistrimit të kësaj ankese, Avokati i Popullit, i ngarkuar nga Kushtetuta dhe ligji për garantimin e mbrojtjes së të drejtave, lirive themelore dhe interesave të shtetasve shqiptarë dhe të huaj nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike shqiptare, në përputhje me nenin 2 të ligjit Nr.8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, ka konstatuar se *rasti plotëson kushtet për t’u konsideruar në kompetencën e tij lëndore, pasi ankuesi është shtetas shqiptar, subjekti ndaj të cilit ai ankohet është organ i administratës publike, dhe objekti i ankesës pretendohet se është një veprim i paligjshëm i kësaj të fundit.*

Për sa më lart, bazuar në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, nenet 13, 17/a dhe 18/a , ka vendosur ta pranohë ankesën dhe të fillojë procedurën e shqyrtimit të çështjes duke ndërmarrë një proces hetimi administrativ.

ANALIZA E INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT, KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

Për shqyrtimin me objektivitet të kësaj ankese dhe për të mundësuar një hetim të plotë administrativ, kemi kërkuar fillimisht nga Bashkia Sarandë të na përcillet informacion nëse qëndron pretendimi i ankuesit, mundësinë e zgjidhjes së problematikës si dhe çdo lloj informacioni që ka të bëjë me rastin. Në përgjigje të kërkesave të përsëritura, na bëni me dije ndër të tjera me shkresën nr.prot 1585, datë 12.05.2020, hyrë në institucionin tonë me nr.prot K3/B29-6, datë 14.05.2020, se ankuesi është vlerësuar nga komisioni i strehimit me 33 pikë dhe është konfirmuar me Vendimin e Këshilli Bashkiak nr.45, datë 05.10.2013, duke u renditur i pari në listën me 307 familje përfituese. Kjo listë shpreheni

se është pezulluar përkohësisht nga Enti Kombëtar i Banesave. Familja e z.H ka përfituar nga skema e bonusit të strehimit edhe për vitin 2018 dhe është orientuar sipas ligjit të ri të strehimit për të përfituar edhe për vitin 2019 duke pasur parasysh nivelin e ulët të të ardhurave familjare që ata disponojnë.

Sa më sipër, i jemi drejtuar për pjesën e parë të problematikës, Entit Kombëtar të Banesave të cilët na bëjnë me dije me shkresën nr.prot 1105/1, datë 12.06.2020, hyrë në Institucionin tonë me nr.prot K3/B29-8, datë 17.06.2020 se ky Institucion ka ndjekur dhe mbikëqyrur zbatimin e programit të kredive të lehtësuara nga shteti si dhe na informojnë mbi procedurat e ndjekura për kreditë e lehtësuara. Duke qenë se familja e z.H nuk ka mundur të përfitojë kredi sipas listës së miratuar nga Këshilli Bashkiak Sarandë në vitin 2013, shprehen se mund të aplikojë sërish në njësinë e vetëqeverisjes vendore Sarandë për të përfituar strehim në një nga format e përcaktuara në këtë akt ligjor. Gjithashtu po në referencë të Ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social”, subvencionimi i qirasë kryhet nga të **ardhurat e njësisë së vetëqeverisjes vendore sipas listave të miratuara nga Këshilli Bashkiak i secilës njësi vendore.**

Duke ju referuar të gjitha arsyetimeve të mësipërme, ju kemi kërkuar shpjegime konkrete për mosmarrjen e bonusit të qirasë për vitin 2019 e në vazhdim të ankuesit; nëse ky qytetar ka vazhduar përfitimin e bonusit të qirasë e cila i është ndërprerë për vitin 2019 e në vazhdim, si dhe çdo lloj informacioni shterues lidhur me këtë çështje.

Lidhur me kërkesat në shkresën e sipërcituar, ndonëse ju jemi drejtuar me shkresa të përsëritura, ende nuk kemi marrë argumentimet/arsyetimet lidhur me shqetësimin e ankuesit/kërkuesit.

Në lidhje me këtë çështje gjejmë rastin t’ju sjellim në vëmendje parashikimet e nenit 22/1 të ligjit nr. Nr.8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar ku saksionohet:

Neni 22/1

Sanksionet për mosbashkëpunimin me Avokatin e Popullit Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga autoriteti kompetent fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil.

Sa i përket shqetësimit të z.H, ai thekson se është drejtuar disa herë për të marrë një përgjigje pranë bashkisë Sarandë pasi kushtet e tij nuk kanë ndryshuar. Ai ka përfituar bonusin e qirasë që nga vitit 2014 deri në vitin 2018 dhe nuk ka marrë në vazhdimësi bonusin e qirasë në zbatim të ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social” duke edhe adresuar drejt përgjegjësive tek personat përkatës.

Pasi kemi analizuar me kujdes shpjegimet e përcjella nga ana juaj, konstatojmë se në shkresën e sipërcituar, Ju na shpjegoni edhe një herë të drejtën dhe përfitimin që ka qytetari por jo arsyen e drejtë të mos përfitimit në vazhdimësi të bonusit të qirasë në zbatim të Ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social” dhe adresimin e përgjegjësive tek personat përkatës.

Në konkluzion të sa u parashtrua dhe arsyetua në këtë rekomandim, vlerësojmë se sjellja e Bashkisë Sarandë përkundrejt ankuesit por edhe përkundrejt adresimit të situatës në tërësi nuk garanton standardin e nevojshëm për qeverisje dhe garanci social ekonomike për qytetarët e grupet në nevojë dhe aq më pak standardin e nevojshëm të garantimit të të drejtave thelbësore të qytetarëve, siç është e drejta për strehim. Për të adresuar

problemetikën e evidentuar dhe për të kontribuar në përmirësimin e qasjes, aq më tepër institucionet e pushtetit vendor si institucione, duhet të garantojnë standardet më të larta për qeverisje në nivel sa më afër qytetarëve.

Bashkitë si dhënëse të shërbimeve duhet të jenë më fleksibël për të adresuar/orientuar qytetarët dhe ofruar shërbimin për çdo qytetar.

Sa më lart, bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 63/3, në të cilin thuhet se : *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga administrata publike”*, si dhe në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”* i ndryshuar, neni 21/b në të cilin thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”*,

REKOMANDOJMË:

- Bashkia Sarandë të adresojë përgjegjësitë dhe të marrë masa konkrete për vazhdimësinë e përfitimit të bonusit të qirasë të shtetasit Z.B.H;
- Kryerjen e një hetimi administrativ për të përcaktuar masën e përgjegjësisë në nivel hierarkik, adresojë përgjegjësitë, ndërmjet strukturave të institucionit lidhur dhe fillimin e procedurës disiplinore ndaj nëpunësve/punonjësve që kanë refuzuar bashkëpunimin me institucionin e Avokatit të Popullit, duke mos reaguar ndaj kërkesave të këtij të fundit.

Lutemi që të njoftohemi brenda 30 ditësh nga marrja e këtij rekomandimi për masat apo veprimet e ndërmarra nga Bashkia Sarandë.

Sipas nenit 21/b të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar paraqitja e këtij rekomandimi pezullon aktet apo veprimet e paligjshme apo të parregullta deri në shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe dhënien e përgjigjes Avokatit të Popullit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Prof.As.Dr.Erjona BANA(CANAJ)